



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

Nr. Prot. 779 Dt 03.04.2023

Senati i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, duke u bazuar në nenin 48 të Statutit të UIBM dhe duke marrë parasysh hyrjen në fuqi të Ligjit 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, në mbledhjen e mbajtur më 30.03.2023, mori:

VENDIM

- I. **ANULOHET** konkursi me nr.protokolli 155 i datës 19.01.2023, për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjerata dhe ushtrime për vitin akademik 2022/2023;
- II. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Senati i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur më 30.03.2023, diskutoi lidhur me implikimet që ka shkaktuar Ligji 08/L-196 për pagat në sektorin publik për konkursin e datës 19.01.2023, me nr. të protokollit 155. Ligji i pagave në nenin 32 dhe Rregullorja nr. 09/2023 për shtesën funksionale, përcaktojnë vetëm shtesat funksionale dhe vlerën prej 20% të pagës bazë dhe nuk përmendin mbinormën apo angazhimin me honorar.

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, është shfuqizuar gjithashtu Rregullorja për të ardhura personale në UIBM, e cila ka paraparë pagesa për orë mbi normë dhe honorare, por gjithashtu edhe fondin e orëve për normë të rregullt javore. Duke pasur parasysh që ka aktualisht ka zbrazëtitirë ligjore lidhur me mbinormën, honoraret dhe mungesën e qartësisë për fondin e orëve që duhet jetë e konkretizuar në kontratë, Senati vendosi si në dispozitiv të vendimit.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit të UIBM;
- Fakulteteve;
- Zyrës për Çështje Akademike;
- Zyrës për Komunikim me Publikun.

Prof. dr. Ajush Musaj
Kryesues i Senatit